

**PROTOKOLLI SANITAR (PARAPRAK)
PËR ORGANIZIMIN E NDESHJEVE NË STADIUM**



28 PRILL 2020

SEKTORI I GARAVE

PËRMBAJTJA

PARAPRAKISHT	3
Ndarja e hapësirave të stadiumit në Zona	4
Predispozitat për klubet	10
<hr/>	
1. Kush hyn në stadium, përveç skuadrave	12
2. Mbërritja e skuadrave në stadium:	13
3. Dhomat e zhveshjes (Ekipet dhe zyrtarët e ndeshjes)	13
4. Nxehmja para ndeshjes	14
5. Hyrja e ekipeve në fushë/ fillimi ndeshjes	14
6. ZONA TEKNIKE (Brenda dhe përreth fushës)	15
7. Pushimi midis pjesëve	15
8. Pas ndeshjes (Zona e mediave me zonën Super Flash / Flash / Gazetarët):	16
9. Intervistat për transmetuesit televiziv të autorizuar	16



PROTOKOLLI SANITAR PER ORGANIZIMIN E NDESHJEVE NE STADIUM

PARAPRAKISHT

Ndeshjet e mbetura për mbylljen e aktiviteteve të futbollit do të zhvillohen pa praninë e tifozëve në Stadione, komplekse sportive apo në afërsi të tyre.

Koncepti përfshin tre aspekte kryesore:

- **Shëndetësore:** Qëllimi është të minimizohet rreziku i transmetimit përmes një skeme paraprake të zhvillimit **të ndeshjeve**. Paraprakisht ekipet do të zhvillojnë fazën parapërgatitore prej 2-Javësh dhe do të kryejnë teste. Këto teste tregojnë nëse një pjesëtar i ekipit aktualisht është i infektuar me virusin Corona. Thelbësore e konceptit është mundësia për të izoluar vetëm personin në fjalë në rast të një testi pozitiv.
- **Sportive:** Aktualisht nuk ekziston një leje zyrtare për stervitje **në grupe të vogla**, gjë **që është kërkesë e klubeve**. Lejet zyrtare janë akoma në pritje për stervitjen e ekipit dhe zhvillimin e ndeshjeve. Sezoni 2019/20 duhet të përfundojë deri më **30 Korrik 2020**. Nëse kjo date shtyhet, afatet do të vlerësohen duke marrë parasysh të gjitha sfidat, siç janë kontratat e lojtarëve dhe jo vetëm.
- **Organizimi:** Në drejtim të organizimit të lojërave pa spektatorë, koncepti bazohet në tre grupe pjesëmarrësish në ndeshje.

NDARJA E HAPESIRAVE TE STADIUMIT NE ZONA

1

Stadiumi do të jetë i ndarë në tre grupe personash sipas karakteristikave të aktivitetit që kryejnë (Zona): Grupi i kuq (Zona 1, Fusha) **përbëhet nga lojtarët, trajnerët**, stafi teknik dhe zyrtarët e ndeshjes. Grupi blu (Zona 2, Tribuna) **përbëhet nga** personat e transmetimeve TV, Stafi dhe Delegacionet e ekipeve dhe disa nga përfaqësues të tjerë të mediave. Ky grup mund të hyjë në stadium, por duhet të mbajë një distancë nga grupi i gjelbër (Zona 1). Grupi i verdhë (Zona 3, Përrreth Stadiumit) përfshin persona **të tjerë të mediave dhe punonjës të tjerë**. Pjesëtarët e këtij grupi mund të qëndrojnë vetëm jashtë territorit të Stadiumit.



ZONA 1: FUSHA

Zona 1, përfshin pjesën e brendshme të Stadiumit si dhe:

> Fusha e lojës

> Kufiri i fushës së lojës duke përfshirë teknike zonë

> Tuneli

> Dhomat e zhveshjes



ZONA 2: TRIBUNA

Zona 2, përfshin të gjitha zonat e tribunes përfshirë dhomat e komandimit

> Tribunë

> Zonat e medias

> Dhoma kontrollit



ZONA 3: PERIMETRI PËRRETH STADIUMIT

Zona 3, përfshin zonat:

> Autobuzet e transmetimit TV

> Zona perreth Stadiumit

Maksimumi 165 persona do të mund të angazhohen në një ndeshje futbollit. Por për shkak të ndarjes në zona, nuk do të jetë I mundur grumbullimi I më shumë se 90 personave në të njëjtën kohë.

Zona 1: Fusha dhe zona teknike	Persona
Zyrtare Ndeshje	6
Lojtare	42
Stafet teknike	16
Femijet e topave	4
Stafi i higjenës	2
Fotografë	2
Shërbimi mjekësor	8
Stewards	4
Media transmetim TV	2
Gjithsej	88

Zona 2: Tribuna	Persona
Siguria Fizike	6
Policia	4
Punonjes te Stadiumit	5
Delegacioni Mik	10
Delegacioni Vendas	10
Gazetarët	10
Komentatore TV live	2
Stafi i higjenës	2
Stafi Transmetimit TV	10
Gjithsej	59

Zona 3: Perimetri i Stadiumit	Persona
Forcat e rendit	20
Regjia TV	3
Punetor Fushe	5
Zjarrfikësit	4
Gjithsej	32

Gjithashtu, impenjimi me I madh I personave do te jete duke filluar 2 ore para fillimit te ndeshjes dhe mbaron me mbarimin e ndeshjes sipas zonave ai do te jete:

ZONA 1, FUSHA

Zona 1: E fushes	Persona	Para	Para	Para	TV Start	Fillim	Fund	TV End
		Ora -8	Ora -6	Ora -4	Ora -2	Ora 0	Ora +2	Ora +4
Zyrtar Ndeshje	6				6	6	6	
Lojtar	22				22	22	22	
Zëvendësues	18				18	18	18	
Staf mbeshtetes	20			8	20	20	20	8
Femijet e topave	4				4	4	4	
Stafi i higjenës	2				2	2	2	
Fotografë (jashte fushes)	2				2	2	2	
Shërbimi mjekësor	4				4	4	4	
Stwards	4	2	2	4	4	4	4	4
Kameraman trans. TV	2	1	1	1	2	2	2	1
Punonjes Fushe	5	5	5	5				5
Gjithsej	89	8	8	18	84	84	84	18



ZONA 2, TRIBUNA

		Para	Para	Para	TV Start	Fillim	Fund	TV End
Zona 2 : Tribuna	Persona	Ora -8	Ora -6	Ora -4	Ora -2	Ora 0	Ora +2	Ora +4
Siguria Fizike	6	2	2	6	6	6	6	2
Policia	4			2	4	4	4	
Punonjes te Stadiumit	5	5	5	5	5	5	5	5
Delegacioni Mik	10				10	10	10	
Delegacioni Vendas	10				10	10	10	
Gazetarët	10				10	10	10	
Analistët e lojërave / videove	2			2	2	2	2	2
Stafi i higjenës	2	2	2	2	2	2	2	2
Stafi Transmetimit Radio/TV	10	3	3	3	10	10	10	3
Gjithsej	59	12	12	20	59	59	59	14

ZONA 3, PERIMETRI I STADIUMIT

Zona 3: Perreth Stadiumit	Persona	Para	Para	Para	TV Start	Fillim	Fund	TV End
		Ora -8	Ora -6	Ora -4	Ora -2	Ora 0	Ora +2	Ora +4
Forcat e rendit	20	4	4	20	20	20	20	4
Stafi Transmetimit Radio/TV	10	4	4	4	10	10	10	4
Punonjes Fushe	5				5	5	5	
Gjithsej	35	8	8	24	35	35	35	8

Punonjes	Para	Para	Para	TV Start	Fillim	Fund	TV End
	Ora -8	Ora -6	Ora -4	Ora -2	Ora 0	Ora +2	Ora +4
Zona 1: E fushes	4	8	18	84	84	84	18
Zona 2 : Tribuna	0	12	20	59	59	59	14
Zona 3: Perreth Stadiumit	8	8	24	35	35	35	8

Koncepti gjithashtu parashikon teste të rregullta për virusin korona për lojtarët dhe stafin teknik. Ndër të tjera, duhet që rezultatet e testit të lojtarëve të bëhen të ditura jo më së vonë se ora 10^{te} e mëngjesit të ndeshjes.

Ky koncept i komunikohet Ministrisë së Sporteve dhe asaj të Shëndetësisë, të cilat më pas duhet të shpalojë kushtet në të cilat është e mundur të rifillojnë stërvitjen dhe kampjonatet.

2

RASTET TE LOJTAREVE/STAFIT POZITIVE TË COVID-19

Në rast të një testi pozitiv me COVID-19 të një lojtari ose pjesëtar të stafit teknik, nuk duhet të bëhet raportim i menjehershëm në media por personi i prekur duhet të izolohet menjëherë dhe persona që ai ka patur kontakt të duhet të testohen, nuk është e nevojshme që i gjithë ekipi të karantinohet. Autoritetet shëndetësore përkatese vendosin për karantinën e mundshme në grup. Sidoqoftë, si masë paraprake, klubet duhet të “sigurojnë një numër të konsiderueshëm lojtarësh në finalen e sezonit”. Ekzistojnë gjithashtu kërkesa të hollësishme për karantinën në shtëpi: personi i infektuar duhet të qëndrojë në dhomë të ndryshme nga anëtarët e familjes së tij dhe të flejë në një shtrat të veçantë. Karantina duhet të perfundojë “zakonisht 14 ditë pas shfaqjes së simptomave”.

Stervitjet dhe vendbanimi

Rregullat e higjienës që zbatohen në ndeshje gjithashtu duhet të zbatohen kur fillon stervitja në ekip, dhe që duhet të jetë plotësisht i mbyllur për publikun. Para se lojtaret të futen në zonën e stervitjes, temperatura e secilit lojtar/staf do matet, dhe ngrënia së bashku nuk do të lejohet. Një distancë prej dy metrash duhet të ruhet në kabinat dhe dushe, gjithashtu lojtaret mund të bëjnë dush në shtëpi. Pajisjet e fitnesit mund të përdoren vetëm me dorëza dhe një maskë për fytyrën dhe më pas duhet të dezinfektohen. Lojtarët duhet të lajnë vetë rrobat dhe këpucët.

Jeta Private

Përveç masave paraprake që janë mese të qarta, masa tjera të tilla si shmangia e mbledhjes së njerëzve, një distancë prej dy metrash nga palët e treta ose larja e rregullt e duarve, profesionistët duhet të pinë shumë ujë në shtëpi, t'i kushtojnë vëmendje një diete të pasur me vitamina dhe “të mbajnë traktin e frymëmarrjes dhe mukozën e tyre sa më të ngrohtë”. Për ta bërë këtë, ata duhet të kontaktojnë personat e tyre të kontaktit dhe të monitorojnë gjendjen e tyre shëndetësore.


PREDISPOZITAT PËR KLUBET

3

Lidhur me pjesën e grumbullimeve stërvitore, ndeshjeve etj., sipas protokollit të OBSH-së dhe rekomandimit të mjekëve, duhen ndjekur dhe zbatuar udhëzimet e mëposhtme në mënyrë rigoroze:

- a. Të gjitha ndeshjet do vijojnë të luhen me dyer të mbyllura. Kërkojmë mirëkuptimin e sportdashësve tanë që të mos vizitojnë ambientet sportive;
- b. Ekipet duhet të demonstrojnë “sjellje shembullore” ndaj botës së jashtme, pasi që në stadium “kerkesa për tu kontaktuar” do të jetë “edhe më e madhe” sesa në situatën aktuale.
- c. Të merren masa nga të gjitha klubet që gjatë grumbullimeve stërvitore dhe ndeshjeve të evitohen kontaktet fizike
- d. Një shërbim mjekësor sanitar, i pajisur me skaner për matjen e temperaturës, në hyrjen e stadiumit, për të gjitha subjektet e autorizuar.
- e. Një dokument me të gjitha normat higjieno-sanitare të adoptuara në secilin impiant sportiv, përpara zhvillimit të çdo eventi, i cili u duhet prezantuar autoriteteve, në rast kërkesë.
- f. Një modul elektronik për të certifikuar subjektet që do të hyjnë në impiant dhe masa kontrolluese për të evituar sa më shumë rrezikun e infeksionit dhe për të mbrojtur interesat e individëve, për të shmangur përhapjen e Koronavirusit.
- g. Sqarim i të gjithë personave të angazhuar për të luajtur në stadium në lidhje me respektimin e masave themelore të higjenës (dezinfektimin e duarve, higjenën e të kolliturit dhe të teshtitjes, distancën) sipas udhëzimeve të autoriteteve shëndetsore.
- h. Të vendosen dezinfektues duarsh në të gjitha këto mjedise për tu ardhur në ndihmë futbollistëve, stafeve dhe zyrtarëve;
- i. Të gjithë stafet të qëndrojnë me maska dhe doreza gjatë punës, para, gjatë dhe pas ndeshjeve;

- j. Përdorimi i maskave dhe dorezave është i detyrueshëm sidomos gjatë udhëtimeve të ekipeve, pra në autobusë, në furgona dhe çdo grumullim tjetër të detyrueshëm në vende të mbyllura;
- k. Kontakti i hershëm i oficerit të higjienës (Doktorit) të klubit me personin kryesor përgjegjës për hotelin (hotele të përshtatshme).
- l. Nëse është e nevojshme, stafi mjekësor i klubit mbërrin më herët për të koordinuar me hotelin (shefin e higjienës, kuzhinier, oficer sigurie, përgjegjës të turnit).
- m. Mbani staf sa më të vogël të jetë e mundur; Kujdestarët duhet të aftësohen në fushën e higjienës; nëse është e mundur, mos merrni me vete asnjë person në rrezik (mosha, sëmundje të mëparshme).
- n. Hotel i dedikuar për ekipin ose kati / zonat ekskluzive për të shmangur kontaktin me vizitorët e tjerë të hotelit.
- o. Stafi i hotelit duhet patjetër të ketë maske në fytyrë gjatë kohës së shërbimit.
- p. Dhomat e lojtarëve të jenë të veçanta (1 lojtar për dhomë).
- q. Dezinfektim i dhomave 2 herë në ditë.
- r. Gjatë ngrenies distanca minimale ndërmjet lojtarëve dhe stafit teknik të jetë 1 metër në tavolinë.
- s. Analiza teknike me lojtarët të bëhet në ambiente të hapura.
- t. Minimizoni kohëzgjatjen e qëndrimit në dhomat e zhveshjes para dhe pas lojës.
- u. Informacion për lojtarët dhe punonjësit me akses në stadium në lidhje me përkufizimin “Simptomat infektive”.
- v. Stafet mjekësore të klubeve dhe akademive, të jenë në kontakt të pandërprerë me autoritetet mjekësore të zonave përkatëse lidhur me raste të mundshme apo të dyshuara. Çdo rast, qoftë edhe i një simptome gripi të lehtë duhet raportuar dhe ndjekur me kujdes.
- w. Të gjithë futbollistët dhe stafet teknike, të evitojnë udhëtimet personale jo të domosdoshme brenda vendit dhe sidomos jashtë vendit (sidomos drejt zonave të deklaruara zyrtarisht si të prekura nga virusi) dhe të reduktojnë takimet apo kontaktet që mund të rrezikojnë shëndetin e tyre dhe personave përreth.



KUSH HYN NË STADIUM, PËRVEÇ SKUADRAVE

4

- a. Stafi Teknik dhe zyrtaret e klubeve përkatëse me funksione organizative të ndeshjes, ne një numër maksimal prej 60 personash. Ndërkohë, në këtë numër nuk bëjnë pjesë fëmijët e topave, mirëmbajtësit e fushës dhe punonjësit e shërbimit të pastrimit në zonat e frekuentuara.
- b. Zyrtarët e ndeshjes.
- c. 10 persona zyrtarë të autorizuar nga çdo skuadër, qëndrimi është i lejuar vetëm në tribunë dhe me një largësi prej 2 metra nga njëri-tjetri.
- d. 4 fëmijë për kapjen e topave.
- e. Përgjegjësit e sigurisë publike 4 persona, stjuardët e parashikuar në zonat e piketuara deri në 20 persona, zjarrfikësit 4 persona, personeli i ndihmës së shpejtë, të parashikuar sipas ligjit.
- f. Vetëm operatorët televizivë dhe gazetarët e rrjeteve titullare të të drejtave të transmetimit “live”.
- g. Fotografët zyrtarë dhe personat e zyres së shtypit të të dyja skuadrave.
- h. Gazetarët dhe fotografët e autorizuar nuk do të jenë më shumë se 20 persona, por ndërkohë ata do të jenë të ndaluar që të kenë kontakte me stafet e dy skuadrave.
- i. Në tribunën e shtypit, të gjithë gazetarët dhe fotografët e akredituar do të duhet të qëndrojnë të paktën 2 metra larg njëri-tjetrit.
- j. Në terrenin e lojës do të mund të zbresin vetëm fotografët zyrtarë të të dyja klubeve. Ndërsa te tjeret do të kenë një vend të rezervuar dhe të kushtëzuar, por kurrsesi brenda rrethimit të fushës.

5


MBËRRITJA E SKUADRAVE NË STADIUM:

- a. Mbërritja e ekipeve me disa autobusë / furgonë (distance minimalisht 1 meter midis lojtarëve dhe stafit stërvitor), e detyrueshme mbajtja e maskave mbrojtëse. Sigurohuni që autobusët të dezinfektohen përpara se ekipi të hyjë në të.
- b. Koha e mbërritjes së skuadrave në stadium për sa i përket kohës ose hapësirës. Distanca kohore prej 15 minutash ndërmjet mbërritjes së ekipeve.
- c. Në varësi të infrastrukturës së stadiumit: Itenerar i rrugëve të ndryshme për në dhomat e zhveshjes.

6

DHOMAT E ZHVESHJES (EKIPET DHE ZYRTARËT E NDESHJES)

- a. Për të minimizuar rrezikun e infeksionit, dyert duhet të lihen të hapura për të mos prekur dorezat e dyerve, ushqimi për ekipet duhet të jete i paketuar në stadium, dhe shishet për pije freskuese duhet të personalizohen.
- b. Koncepti gjithashtu rekomandon përdorimin e dusheve individuale ose dush në shtëpi/ hotel. Zonat e SPA janë plotësisht të ndaluara.
- c. Rekomandim urgjent për të përdorur më shumë hapësira ose dhoma zhveshje.
Rekomandohet të jene ne dhomat e zhveshjes lojtaret titullare.
- d. mund të kemi grumbullime lojtarësh në hapësirën e zonës teknike



NXEHMJA PARA NDESHJES

7

- a. Adaptimi kohës së nxehmjes ndërmjet dy skuadrave, të shmanget grupimi lojtarëve.
- b. Shmangia e përdorimit të njëkohshëm të hyrjes në fushë dhe në dhomat e zhveshjes (tunelit).

HYRJA E EKIPEVE NË FUSHË/ FILLIMI NDESHJES

8

- a. Pa fëmijë shoqërues
- b. Pa maskot
- c. Asnjë fotografi me skuadren (fotografë vetëm pas portës dhe nga ana e karshisë)
- d. Asnjë ceremoni hapëse me njerëz të huaj (këngëtarë, animatorë, etj)
- e. Pa shtrëngim duarsh
- f. Asnjë rreshtim të ekipeve

9


ZONA TEKNIKE (BRENDA DHE PËRRETH FUSHËS)

- a. Duhet të jenë vetëm trajnerët, lojtarët dhe stafet mjekësore, arbitri 4-të, kameramanët e fushës , shërbimi mjekësor.
- b. Mbajtja e maskave nga të gjithë personat në pankinë është e detyrueshme gjatë gjithë ndeshjes.
- c. Trajneri mund të mos mbajë maske, por ai duhet të qëndrojë në një distancë minimalisht 2 metra nga personat e tjerë në pankinë.
- d. Trajneri nëse nuk ka maske nuk mund të afrohet me lojtarët në fushë. Ai duhet të mbajë një distancë minimalisht 2 metra nga çdo lojtar.
- e. Minimizimi i konceptit të TV në brendësi
- f. Të vendoset 1 person në çdo 2-3 ndenjësë.
- g. Opsionet e zgjerimit të bankinave: zona e stërvitjes (nëse ka qasje të drejtpërdrejtë) ose karrige / stola shtesë përveç stolave të zëvendësimit (idealisht të mbuluar)
- h. Përshtatja e zonës teknike

10

PUSHIMI MIDIS PJESËVE

Hyrja për në dhomat e zhveshjes, në mënyrë analoge si para ndeshjes.



PAS NDESHJES (ZONA E MEDIAVE ME ZONËN SUPER FLASH / FLASH / GAZETARËT):

11

- a. Salla e shtypit dhe zona mix mbetet e mbyllur.
- b. Konferenca për shtyp zhvillohet vetëm për kanalin zyrtar të skuadrës.

INTERVISTAT PËR TRANSMETUESIT TELEVIZIV TË AUTORIZUAR

11

- a. Pas ndeshjes do të mund të lejohen që të bëjnë intervista vetëm rrjetet e të dyja klubeve dhe ato që kanë të drejtën e transmetimit LIVE. Do të zgjidhet vetëm një rrjet transmetues i jashtëm (një gazetar i një televizioni të huaj, që bën shpërndarjen në Europë dhe në botë), të cilët duhet të jenë të pajisur me një mikrofon me zgjatues që do të dezinfektohet pas çdo interviste, ndërsa kufjet e përdorura për lidhjet direkte do të jenë njëpërdorimshe.
- b. Nuk do të ketë intervista, as për televizionet e klubeve, për lojtarët që zbresin nga autobusi apo në prag të hyrjes së dhomave të zhveshjes.
- c. Nuk do të lejohen intervistat “flash” në terrenin e lojës, as përpara dhe as prapa ndeshjes apo akoma më shumë kamerat gjatë nxehmjes dhe pas ndeshjes, në dhomat e zhveshjes së të dyja skuadrave.
- d. Për të evituar qëndrimin e gjatë në vende të mbyllura, gazetarëve do të bëjnë analizat e mundshme dhe lidhjet direkte me studiot e tyre t'i bëjnë në hapësirat e mediave në tribunat e stadiumeve të ndryshme.



FEDERATA
SHQIPTARE E
FUTBOLLIT